

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

Nr. 14452 Rep.

Nr. 5040 Kol.



Marrëveshje Transferimi të Pjesëve të Kapitalit
(Transferimi i Kuotave)

Në Tiranë, sot më 22 Nentor 2012, para meje Julian Zhelegu, anëtar i Dhomës së Noterëve të Tiranës, me seli ne Rr. "Pjeter Bogdani", nr. 13, palët e kësaj Marrëveshjeje si më poshtë:

- **Shitësi:** "A & M" SHPK, një shoqëri shqiptare me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas ligjeve të Shqipërisë, regjistruar në datë 31.08.2007, me seli në Rruga Kombëtare, Tepelenë – Memaliaj, Tepelenë, përfaqësuar nga Z. Elidon Malaj, shtetas shqiptar, lindur më 02.03.1974, në Tepelene, zotërues i letërnjoftimit nr., 027164939, i cili në bazë të vendimit të ortakut të vetëm datë 22.11., 2012, ka të drejtë të nënshkruarjë këtë Kontratë (qe ketu e me poshte referuar "SHITESI")

dhe

- **Blerësi:** Z. Laert Duraj, shtetas shqiptar, i biri i Seitit, lindur me 10.11.1972, ne Tepelene e banues ne Tirane, mbajtes i kartes se identitetit me nr. 029871334, madhor e me zotesi te plote juridike e per te vepruar; (qe ketu e me poshte referuar "BLERESI"),

MEQENESE:

- A. Shitësi zotëron 100 Kuota qe perfaqesojne 100 % të Kapitalit te Shoqërisë "Blue Point Petroleum" sh.p.k. (ish EKO PETROLEUM ALBANIA SHPK) një shoqëri shqiptare, e themeluar dhe qe vepron sipas ligjeve shqiptare, regjistruar me nr. NUIS K01318005N, me një kapital prej 810.884.740,00 LEK, të ndarë në 8.108.847,4 kuota me vlerë nominale prej 100 LEK secila, me seli ne Tirane, Shqipëri ("Shoqëria");
- B. Blerësi deshiron te transferoje ne pronesi te tij 40 kuota qe perfaqesojne 40 % te kapitalit te shoqerise te zoteruara nga shitesi ne shoqerine "Blue Point Petroleum" Sh.p.k., sic percaktohet ne kete marreveshje.
- C. Në përputhje me Nenet e Statutit të Shoqërisë dhe ne mbeshtetje te Ligjit shqiptar "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Nr. 9901, date 14.04.2008, eshte miratuar transferimi i kuotave sipas kesaj marreveshjeje.

Per sa me siper palët bien dakort si më poshtë:

1. Shitësi deklaron se ka marrë nga Blerësi në mënyrë të plotë të gjithë çmimin e blerjes të rënë dakord në vlerën prej **850 000 Euro** (teteqind e pesëdhjetë mijë euro) në llogarinë e tij bankare pranë Bankes BKT dhe për këtë arsye transferon këtu 40 Kuotat që përfaqësojnë 40% të Kapitalit të zotëruar prej tij në Kapitalin e Shoqërisë "Blue Point Petroleum" Sh.p.k., në pronësi të Blerësit. Shitësi deklaron dhe garanton Blerësin se Kuotat e transferuara këtu, janë në pronësinë e tij të plote e ligjore.
2. Blerësi pranon pronësinë e këtyre 40 Kuotave në shitje, duke njohur gjendjen e Shoqërisë si dhe bie dakort me të gjitha të drejtat dhe detyrimet e lindura nga zotërimi i këtyre Kuotave brenda Shoqërisë, sipas përcaktimeve të Statutit të Shoqërisë dhe ligjit shqiptar.
3. Shitësi dhe Blerësi bien dakort të zbatojnë dhe të paraqesin që në kërkesën e parë të palës tjetër dhe/ose të Shoqërisë të gjitha dokumentet e nevojshme në mënyrë që të kryejnë të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e transferimit të këtyre Kuotave objekt të kësaj Marrëveshjeje, pranë Qendrës Kombëtare e Regjistrimit si dhe në çdo autoritet tjetër sipas përcaktimeve të Ligjit Shqiptar.
4. Secila nga Palet mund të paraqesë dokumenta, informacione dhe prova që ajo Pale i disponon në lidhje me çdo çështje të kësaj Marrëveshjeje, me qëllimin që të ruajë e të përforcojë çdo të drejtë të kësaj, Pale në kuptim të kësaj Marrëveshjeje.

Kjo Marrëveshje u hartua në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe me vlerë të barabartë ligjore. Marrëveshja bazohet në nenin 705 të Kodit Civil (Shqiptar) dhe në Ligjin shqiptar "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Nr. 9901, datë 14.04.2008. Marrëveshja iu lexua përpara palëve, u gjend e rregullt, në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë dhe u nënshkrua rregullisht.

Nënshkruar e vëlosur dhe prej meje noterit, në përputhje me ligjet në Republikën e Shqipërisë, sot me dt. 22, .11.2012.


SHITESI: A & M sh.p.k.




BLERESI: Laert Duraj

Noteri
Julian Zhelegu